



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 prill 2016
Nr. ref.:RK922/16

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

Rastin nr. KI147/15

Parashtrues

SH.P.K. "SYRI"

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme, E. Rev. nr. 10/2015, të 14 tetorit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është SH.P.K. "SYRI" nga Gjakova (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, E. Rev. nr. 10/2015, të 14 tetorit 2015, Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr. 126/2013 të 9 tetorit 2014, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, C. nr. 198/2007, të 19 majit 2008.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së 3 (tre) aktgjykimeve, me të cilat pretendohet se parashtruesit i janë shkelur të drejtat dhe liritë të garantuara me nenin 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) të Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6, nenin 13 dhe nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 29 dhe 32 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 14 dhjetor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 22 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 2 shkurt 2016, Gjykata njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Gjithashtu, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, si dhe vendimet të cilat i konteston.
9. Parashtruesi nuk u përgjigj në kërkesën e Gjykatës.
10. Më 16 mars 2016, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në Rastin KI147/15, Gjykata vërejt se parashtruesi ka dorëzuar kërkesën e cila përbëhet nga 2 (dy) faqe, në bazë të së cilave nuk mundet të konkludohet se cila është esenca e kontestit dhe si kishte

ardhur deri te shkeljet e pretenduara mbi të cilat parashtruesi e ka ndërtuar kërkesën e tij.

12. Gjykata mund të vërej vetëm se parashtruesi i kërkesës i konteston këto aktgjykime:
 - a) Aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, C. nr. 198/2007, të 19 majit 2008;
 - b) Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae. nr. 126/2013, të 9 tetorit 2014; dhe
 - c) Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 10/2015, të 14 tetorit 2015.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi në kërkesë theksoi: *“Çdo person fizik ose moral ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.*
14. Parashtruesi kërkon: *“që vetë Gjykata të sigurojë të gjithë dokumentacionin nga Gjykata Themelore në Prishtinë lidhur me këtë rast”.*

Pranueshmëria e kërkesës

15. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse ajo i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
16. Në këtë kuptim, neni 113 paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.
17. Gjithashtu, neni 48 i Ligjit, përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.
18. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 29 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës:

“(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(g) arsyetimin procedural dhe substantiv të kërkesës; dhe

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës”.

19. Si dhe rregullin 32 (Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës) të Rregullores së punës, i cili parashikon:

(5) “Gjykata mund të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze”.
20. Në rastin konkret, Gjykata vërejtë se parashtruesi në kërkesën e tij të 14 dhjetorit 2015, ka kërkuar në mënyrë eksplicite që Gjykata të sigurojë *ex officio* të gjithë dokumentacionin, si dhe aktgjykimet të cilat ai i konteston, nga Gjykata Themelore në Prishtinë.
21. Gjykata thekson se përkundër kërkesës për dokumentacion mbështetës, të cilën ia kishte dërguar parashtruesit më 2 shkurt 2016 dhe në të cilën ka kërkuar që ai ta plotësojë kërkesën e 14 dhjetorit 2015 me dokumentacionin e nevojshëm, në mënyrë që Gjykata të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e tij, ai nuk e ka bërë një gjë të tillë.
22. Gjykata thekson se është obligim i parashtruesit të kërkesës që të ndërtojë rastin dhe të dorëzojë në Gjykatë të gjithë informatat e nevojshme për të qenë në gjendje ta shqyrtojë rastin.
23. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se në këtë rast nuk mund të merr në shqyrtim një kërkesë, sepse nuk janë plotësuar të gjitha kushtet procedurale të parashikuara me Rregulloren e punës.
24. Prandaj, kërkesa duhet të refuzohet në pajtim me rregullat 29 dhe 32 (5) të Rregullores së punës, sepse është e paplotë për shqyrtim.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me rregullat 29 dhe 32 (5) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 16 mars 2016, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi